

Në bazë të nenit 27 paragrafi 2 të Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 61/04,96/04,67/07,156/09,47/11, 192/158 dhe 209/18) dhe nenit 8 të Ligjit për mbështetje financiare të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe shfrytëzuesve individual të themeluar nga njësitë e vetëqeverisjes lokale për financimin e obligimeve të arritura e të papaguara („Gazeta zyrtare e RM" nr.209/18 dt.15.11.2018), kryetari i komunës së Zhelinës, shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Tek kreditorët e komunës së Zhelinës dhe kreditorët e shfrytëzuesve individual, të themeluar nga komuna e Zhelinës në fushën e arsimit, mbrojtjes së fëmijëve dhe mbrojtjes sociale për paraqitjen e kërkesave të arritura dhe të papaguara

Thirren kreditorët e komunës së Zhelinës, kreditorët e shfrytëzuesve individual të themeluar nga komuna e Zhelinës në fushën e arsimit, mbrojtjes sociale e të fëmijëve t'i paraqesin kërkesat e arritura e të papaguara.

Afati për paraqitjen e kërkesave është 8 (tetë) ditë pune nga dita e shpalljes së Thirrjes publike.

Dita e shpalljes së Thirrjes publike nuk përllogaritet në afat.

Të drejtën e paraqitjes së kërkesës e kanë të gjithë kreditorët për kërkesat e arritura e të papaguara, që janë paraqitur në sistemin elektronik për paraqitje dhe evidentim të detyrimeve përfundimisht me shtatorin e vitit 2018, me qëllim të përcaktimit me marrëveshje të shumës së detyrimeve.

Me fletëparaqitje, në të cilën do të shënohet nëse i referohet komunës apo shfrytëzuesve individual të themeluar nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, kreditorët obligohen të dorëzojnë edhe këtë dokumentacion: Kontratë ose akt tjetër juridik prej ku rezulton kërkesa ndërmjet komunës së Zhelinës dhe kreditorit -Fatura/Gjendja e ngarkesës me borxh (kartela analitike).

Dokumentacioni tërësisht i plotësuar dorëzohet në origjinal ose në kopje. Në qoftë se dokumentacioni dorëzohet në kopje, besueshmërinë e secilës faqe, parashtruesi i kërkesës e vërteton me vulë dhe nënshkrimin e tij.

Fletëparaqitjen e kërkesës për paraqitjen e Thirrjes publike, parashtresit e kërkesës mund ta marrin në arkivin e komunës së Zhelinës ose nga web faqja e komunës së Zhelinës: [www. zhelina.gov.mk](http://www.zhelina.gov.mk)

1. Afati dhe mënyra e dorëzimit të fletëparaqitjeve

Afati i dorëzimit të fletëparaqitjeve është 8 (tetë) ditë pune nga dita e shpalljes së Thirrjes publike.

Thirrja publike dhe formularët "Fletëparaqitja e kërkesës në pajtim me Thirrjen publike tek kreditorët e komunës së Zhelinës dhe kreditorët e shfrytëzuesve individual të themeluar nga komuna e Zhelinës, në fushën e arsimit, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve për paraqitjen e kërkesave të arritura e të papaguara do të shpallen në web faqen e komunës së Zhelinës.

Fletëparaqitja me dokumentacionin e plotë të dorëzohet përmes postës me dërgesë rekomanduese ose personalisht në arkivin e komunës së Zhelinës, (nga ora 8:00 deri ora 16:00 çdo ditë pune) në f. Zhelinë, Rruga 101. pn. 1226

Gjithashtu, fletëparaqitjen mundeni ta shkarkoni në këtë lidhëze: >> [FLETËPARAQITJE PËR BORXHET](#)

Fletëparaqitjet me dokumentacionin e plotë që janë pranuar pas skadimit të afatit nuk do të merren parasysh.

Informata më detale subjektet juridike të interesuar mund të marrin në numrin e telefonit: 070282292 ose në adresën elektronike: adil-emini@hotmail.com

Pas përfundimit të Thirrjes publike, komuna e Zhelinës në afat prej 8 (tetë) ditësh do t'i shqyrtoj fletëparaqitjet e arritura, kurse kryetari i komunës së Zhelinës do të procedoj në pajtim me Ligjin për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.61/04 96/04, 67/07, 156/09, 47/11,192/158 dhe 209/18), Ligjin për mbështetje financiare të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe shfrytëzuesve individual të themeluar nga njësitë e vetëqeverisjes lokale për financimin e obligimeve të arritura e të papaguara ("Gazeta zyrtare e RM" nr.209/18 dt. 15.11.2018).

Për obligimet e komunës, kryetari i komunës vepron ndaj negociatave me të gjithë kreditorët që janë paraqitur në Thirrjen publike për përcaktimin me marrëveshje të shumës së obligimeve, respektivisht uljen e obligimeve për komunën, për çka përpilohet dhe nënshkruhet procesverbal për çdo kreditor.

Për kohën dhe vendin ku do të mbahen negociatat kreditorët e paraqitur do të njoftohen në mënyrë plotësuese.

Nr. 09-1887/1

11.12.2018

Zhelinë

Kryetari i Komunës së Zhelinës

Blerim Sejdiu